

VENDIM
Nr.346, datë 20.5.2005

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “ARMONIA TV”
SUBJEKTIT:SHOQËRIA “DROPULL” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë“, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë“ të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Dropull” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Gjirokastër.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj